



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 nëntor 2017
Nr. ref.: RK1151/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI92/17

Parashtrues

Shemsi Peshku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-16-0221, të 26 tetorit 2016

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shemsi Peshku, me banim në Barilevë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-16-0221, të 26 tetorit 2016, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 13 nëntor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesë Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 gusht 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 15 gusht 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 16 gusht 2017, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga ai që të bashkëngjitë fletëkthesën që dëshmon se kur e ka pranuar Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-16-0221, të 26 tetorit 2016. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Kolegjin e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 28 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës ka njoftuar Gjykatën se nuk ka njohuri se kur e ka pranuar aktvendimin e lartpërmendur.
9. Më 30 gusht 2017, Gjykata kërkoi nga Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), që të informon Gjykatën se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-16-0221, të 26 tetorit 2016.
10. Më 5 shtator 2017, Kolegji i Apelit, dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se parashtruesi i kërkesës aktvendimin e lartpërmendur, e ka pranuar më 13 nëntor 2016.

11. Më 24 tetor 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore “Kosova Export-Bujqësia” (në tekstin e mëtejme: NSH), e cila në një datë të paspecifikuar është privatizuar.
13. Më 12 prill 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të cilët e kishin fituar të drejtën legjitime për një pjesë të të ardhurave të realizuara nga privatizimi i NSH-së. Afati për parashtrimin e ankesës ndaj listës përfundimtare në DHPGJS ishte 3 maj 2010.
14. Më 18 janar 2016, parashtruesi ushtroi ankesë në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar) ndaj listës përfundimtare të AKP-së, duke kërkuar që të përfshihet në këtë listë.
15. Më 10 shkurt 2016, AKP-ja u përgjigj në ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se parashtruesi i kërkesës ankesën e tij e ka parashtruar pas afatit të paraparë ligjorë.
16. Më 13 shtator 2016, Kolegji i Specializuar [Aktvendimi C-II-16-0011-C0001], kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të paafatshme.
17. Më 10 tetor 2016, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit ndaj Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar, C-II-16-0011-C0001, të 13 shtatorit 2016, duke pretenduar që afatin ligjorë e ka humbur për shkak se është i moshuar dhe se nuk ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore.
18. Më 26 tetor 2016, Kolegji i Apelit [Aktvendimi AC-I-16-0221] refuzon ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërteton Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar, C-II-16-0011, të 13 shtatorit 2016. Kolegji i Apelit në aktvendimin e tij ka dhënë përgjigje të detajuar në të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-16-0221, të 26 tetorit 2016, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
20. Parashtruesi pretendon që deri te shkelja e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë ka ardhur si rezultat i refuzimit të kërkesës për shkak të lëshimit të afatit pasi që, parashtruesi pretendon se ka qenë i moshuar, në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe i painformuar.

21. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i shfuqizojë vendimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe t'i njihet e drejta në pjesëmarrje në 20% nga Privatizimi i N. SH.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafëve 1 dhe 7, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit [Afatet], i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

25. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (c) të Rregullores së punës, me të cilin theksohet që:

“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...] (c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit; ose [...].

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 nëntor 2016, derisa kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 14 gusht 2017. Rrjedhimisht, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë jashtë afatit ligjor 4 (katër) mujor.

27. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005 dhe po ashtu, shih rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

28. Përveç kësaj, Gjykata thekson se afati ligjor 4 (katër) mujor llogaritet nga dita kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar, pas shterimit të mjeteve juridike, vendimin e kontestuar. (Shih, për shembull, rastin *Hatip Çelik kundër Turqisë*, GJEDNJ, aplikacioni nr. 52991/99, Aktvendim i 23 shatorit 2004).
29. Gjykata thekson se është detyrë e parashtruesve të kërkesave apo përfaqësuesve të tyre që të veprojnë me 'kujdes të nevojshëm' (*due diligence*) për t'u siguruar se kërkesat e tyre për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore janë dorëzuar brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës. (Shih rastin *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, [DHM], aplikacionet nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykimi i 17 shtatorit 2014, paragrafët 263-267).
30. Rrjedhimisht, kërkesa deklarohet e papranueshme për shkak se nuk është dorëzuar brenda afatit, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 24 tetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

